



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:132427

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05422178

C.nr.2044/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve Z.B. me numër personal dhe M.K. me numër personal që të dy nga Prizreni, të cilat me autorizim i përfaqëson Av. F.S. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja ligjore V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i shujtave, vlera e kontestit shtatëqind e dhjetë euro (710.00 €), jashtë shqyrtimit kryesor, me datë **07.03.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve Z.B. dhe M.K. që të dy nga Prizreni, **DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësve ti paguaj shumat si në vijim:

- Paditëses Z. B. në emër të shujtave ditore për 158 ditë pune (nga data 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022), ti paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo shumën e përgjithshme prej treqind e gjashtëmbëdhjetë euro (316.00 €).
- Paditësit M.K. në emër të shujtave ditore për 197 ditë pune (nga data 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022), ti paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo shumën e përgjithshme prej treqind e nëntëdhjetë e katër euro (394.00 €), apo shumën e përgjithshme prej shtatëqind e dhjetë euro (710.00 €), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (12.06.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro (176.00 €) në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit Z.B. dhe M.K. që të dy nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre F.S. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datën 12.06.2023, kanë parashtruar padi, të cilën e ka precizuar me parashtresën e datës 31.10.2023, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimin shujtave ditore, vlera e kontestit shtatëqind e dhjetë euro (710.00 €).

I autorizuari i paditësve në padi ka theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune si mësimdhënës në SHFMU “Motrat Qiriazit” në Prizren. Paditësit kanë bërë përpjekje që ti realizojnë të drejtat e tyre lidhur me realizimin e pagesës së shujtave ditore për vitin 2022, por përpjekja e tyre ka rezultuar pa suksese, provë kërkesa dorëzuar DKA-së me nr.1147/23 e datës 25.05.2023 dhe përgjigjja me nr.1166/23 e datës 29.05.2023, e dhënë nga Drejtoria e Arsimit në Prizren. Sipas të autorizuarit të paditësve, baza juridike e kërkesëpadiës nuk është kontestuese, pasi bazuar në Kontratën Kolektive të vitit 2021, paditësve u takon e drejta në kompensimin e ushqimit në punë nga ana e të paditurës. Gjykatës i ka propozuar, që pas administrimit të provave e njëjta të merr aktgjykim ashtu që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. Ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësit nuk kanë ofruar ndonjë provë që janë anëtarë të sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësve është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet me organizatën së punëdhënësit dhe organizatën së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënës pranë SHFMU “Motrat Qiriazit” në Prizren.

Gjykata përmes vërtetimit me numër 478/108 të datës 24.10.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHFMU “Motrat Qiriazi” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësja Z.B. është në marrëdhënie pranë kësaj shkolle dhe në vitin shkollor 2022, nga data 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 158 ditë pune.

Gjykata përmes vërtetimit me numër 478/65 të datës 24.10.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHFMU “Motrat Qiriazi” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësi M.K. është në marrëdhënie pranë kësaj shkolle dhe në vitin shkollor 2022, nga data 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 197 ditë pune.

Vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj pasi këto vërtetime janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimeve të SHFMU “Motrat Qiriazi” në Prizren, gjykata i’a fali besimin e plotë, si prova me të cilën vërtetohet fakti lidhur me vendin dhe ditët e punës, konkretisht paditësit Z.B. dhe M.K. që të dy nga Prizreni, gjatë vitit shkollor 2022, nga data 01.01.2022, deri me datë 21.11.2022, kanë punuar secila nga 158 dhe 197 ditë pune.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës .22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të KKAk-së nr.prot. Nr. 01B/ 105 e datës 22.01.2021 është paraparë se *“Të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*, ndërsa neni 45 thuhet se *“Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i sajë vazhdon edhe për një vite”*. Me nenin e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë mbulohet periudha e kërkesës së paditësit prej 01.01.2022 deri 21.11.2022.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësve, t’ia paguaj kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës .22.01.2021, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës .22.01.2021, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (12.06.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 156.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 176.00 euro.

Gjykata gjeti si pjesërisht të bazuar kërkesën e paditësit që lidhur me kompensimin e shpenzimeve gjyqësore për përpilimin e padisë ti kompensohet shuma prej 208.00 €, pasi që bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve, kompensimi për përpilimin e parashtrësive në procedurë civile, tek kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000 €, për paditësin e dytë është paraparë në lartësi prej 156.00 €.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:132427, 07.03.2024

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.